



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.59/2019
Prishtinë, më 26.02.2019, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Lutfi Zharku, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtare.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Liburn Aliu dhe Hykmete Bajrami, anëtare.

I ftuar: Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës: Shkumin Asllani dhe Lulzim Demolli –MZHE, Dardan Abazi-INDEP, Shkëlqim Mehmetaj – KDI, Lirdon Gashi –SEEF, Blerim Sallahu, Fatbon Bunjaku dhe Vatra Qehaja – LVV, Nora Kelmendi–Ekonomia Online, Albulena Mavraj- Epoka e Re, Fazli Aliu-RTK, Majlinda Doda-Radio Kosova, Arbisa Shefkiu-Kallxo/Birn, Ardiana Thaçi–KTV, Sanije Jusufi-Koha Ditore, Albana Hajdari-Kosova Post, dhe Agnesa Çitaku-Arbresh. Info.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit, e ndihmuar nga deputeti Muharrem Nitaj.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.2.2019;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/85 datë 22.1.2019 me të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike “Telekomi i Kosovës” SH.A.;
4. Diskutim për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.2.2019

Procesverbali nga mbledhja e datës 12.02.2019 u miratuan pa vërejte.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/85 datë 22.1.2019 me të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike “Telekomi i Kosovës” SH.A.

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit në lidhje me procedurën kronologjike se si është marrë ky vendim si vijon: Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 30.1.2019, ka pranuar Vendimin e Qeverisë nr.05/85 datë 22.1.2019, më të cilin autorizohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Ndërmarrjes Publike Qendrore “Telekomi i Kosovës” SH.A. Në këtë “Vendim” të Qeverisë, në pikën 4 të tij, është obliguar sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që ky vendim t’i procedohet për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këtë vendim – për procedim në Kuvend - Qeveria e mbështet në nenet 5 dhe 9 të Ligjit për ndërmarrje publike. Neni 5, i këtij ligji, përcakton qartë se “5.1 Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore”, ndërsa, neni 9, thotë: “9.1 Aksionet në një NP Qendrore mund të shiten lirisht nëse Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi, Komisioni Qeveritar për Privatizim është i autorizuar të kryejë një tender dhe t’i shesë aksionet në fjalë.”. Andaj, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, është ftuar z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, të cilit ia kaloi fjalën për ta paraqitur këtë vendim.

Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, i njoftoi anëtarët e Komisionit në lidhje me procesin se si kanë rrjedhur procedurat e marrjes së Vendimit të Qeverisë nr.05/85 datë 22.1.2019 si vijon: Ministria e Zhvillimit Ekonomik është thellësisht e preokupuar me gjendjen financiare dhe operative të ndërmarrjes publike ‘Telekomi i Kosovës’. Me theks gjatë 4 viteve të fundit kjo ndërmarrje ka shënuar humbje të vazhdueshme të cilat variojnë nga 52 deri në 8 milionë euro. Problemet e akumuluar me vite, trendët globale të zhvillimit tekniko-teknologjike, vendimet paraprake dhe proceset jo të suksesshme për privatizimit të pjesshëm të kësaj ndërmarrje, si dhe proceset e shumta gjyqësore të humbura kanë provokuar gjendje të rëndë financiare, duke pamundësuar zhvillimin tutje të saj e që sot që flasim seriozisht rrezikojnë likuiditetin e tërësishëm dhe qëndrueshmërinë në treg. Me lejoni të ju njoftoj se nga marrja e mandatit si ministër kam punuar intenzivisht për të adresuar secilin problem të kësaj ndërmarrje dhe gjetur zgjidhje të përshtatshme. Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike kam trajtuar seriozisht rritjen e performancës së ndërmarrjes duke përforcuar mekanizmat monitorues të gjithë secilit aktivitet brenda saj. Për më tepër, kam nxjerrë vendim për ndalimin e të gjitha kompensimeve shtesë për strukturat udhëheqëse të kësaj ndërmarrje, kjo me qëllim të respektimit strikt të secilës dispozitë të ligjit për ndërmarrjet publike dhe parimeve të qeverisjes korporative. Po ashtu, në bashkëpunim me Bordin e Drejtorëve kemi hapur procesin e ristrukturimit të ndërmarrjes, si dhe kam ftuar Bankën

Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim që të marrë përsipër këtë ristrukturim të thellë dhe ripozicionim të ndërmarrjes, ristrukturim ky i cili do të përfshijë: a) ristrukturimin e borxhit, ristrukturimin e kapitalit dhe financimin e investimeve b) masat organizative dhe të ristrukturimit të fuqisë punëtore, si dhe c) identifikimin e masave të ristrukturimit të biznesit; duke konsideruar në veçanti përmirësimin e operacioneve aktuale, afrimin e shërbimeve të reja, vlerësimin dhe përmirësimin e teknologjisë, si dhe kërkesat për investime urgjente dhe ato në zhvillim për një periudhë 1-3 vjeçare. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në përmirësimin e gjendjes në ndërmarrjen Telekomit i Kosovës. Jemi të bindur që implementimi i masave emergjente implementimi i planit të ristrukturimit, si dhe qartësimi i disa prej marrëveshjeve komerciale të kësaj ndërmarrje do të kthejë të njëjtën në fitim-prurëse dhe të dobishme për Republikën e Kosovës. Për sa i përket vendimit të fundit për hapjen e procesit të privatizimit, ju njoftoj se ky vendim është në përputhje me planin qeverisës të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021. Vendimi për themelimin e Komisionit Qeveritar për Privatizim është në përputhje me nenin 9 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike i cili, citoj: “Aksionet në një NP Qendrore mund të shiten lirisht nëse Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi, Komisioni Qeveritar për Privatizim është i autorizuar të kryejë një tender dhe t’i shesë aksionet në fjalë.” Pra, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ky vendim kërkon aprovimin e Kuvendit të Kosovës, kjo në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve dhe pronësinë e ndërmarrjeve publike. Për vëmendjen tuaj, komisioni konstituhet vetëm pas aprovimit të vendimit nga Kuvendi i Kosovës. Tutje, me lejoni të nënvizoj se cilitdo rekomandim të Komisionit të sapo themeluar me vendim të Qeverisë së Kosovës për privatizim ose jo do i paraprijë procesi i ristrukturimit dhe riorganizimit të tërësishëm të kësaj ndërmarrje. Sot, nuk përjashtohet as nuk paragjykohet asnjë rekomandim. Privatizim i plotë apo privatizim i pjesshëm. Megjithatë, ajo që parapra kisht është kryesore e që i paraprinë rekomandimit finale të komisionit; është fillimi dhe përfundimi i procesit të ristrukturimit mbi premisat krejtësisht korporative, siç u cek më lart. Gjithashtu, sqaroj se këtij procesi privatizues do i paraprijë: Vlerësim i drejtë dhe paraprake të vlerës së ndërmarrjes, Transparencë, Konkurrencë, Partner serioz, Shfrytëzimi i strukturave ekzistuese e dialog social dhe interesi i të punësuarave është primar dhe do të ruhet. Me lejoni të nënvizojë bindjen e thellë se përfundimi i këtij procesi do të ketë ndikim shumëdimensional për ndërmarrjen në: a) rritjen e aftësisë konkurruese, b) transferimi e dijes dhe inovacionit teknologjik c) optimalizimit të kostos së operimit, si dhe d) diversifikimin të produkteve të shërbimit.

Lutfi Zharku tha se si LDK në parim, si koncept e përkrah privatizimin e Telekomit, por nuk mundem më voto diçka që është sipas ligjit në kundërshtim me parime bazë të privatizimit, përderisa nuk e kemi një raport të hollësishëm nga menaxhmenti dhe Bordi i Telekomit se në çfarë gjendje afariste operon në këtë rast Telekomit si ndërmarrje publike.

Glauk Konjufca tha që mënyra e marrjes së Vendimit të Qeverisë për privatizimin e Ndërmarrjes Publike Telekomit i Kosovës, është në kundërshtim dhe me Kushtetutën e Kosovës, sipas nenit 93, pika 3, ku thotë që vendimet e Kuvendit të Kosovës dhe ligjet që miratohen dhe aktet e tjera, duhet të zbatohen nga Qeveria dhe në këtë rast Qeveria nuk është në përputhje me Rezolutën për Telekomit të cilën e ka miratuar Kuvendi para një kohe, e në të cilën thotë që

nuk duhet me u privatizuar Telekom, por të bëhet ristrukturimi i saj. Ai tha arsyeja pse ndërmarrja publike Telekom po fundoset, është pasi qeveritë e kaluara kanë qenë të fokusuar në drejtim të përfituesve privat. Pastaj parashtroi disa pyetje: Pse nuk po e shkëputni kontratën që e ka Telekom me Z-Mobile kur dihet që kjo kontratë e dëmshme e ka sjellë ndërmarrjen para falimentimit? Për marrjen e objekteve me qira, që ka marrë Telekom këtu nuk kemi pasur një hetim sa i përket keqpërdorimit, ku janë vjedhur me miliona euro, a keni raport për këto shpenzime nga Bordi i Telekomit? Kompaninë “Artillery One”, ka nënshkruar marrëveshje konfidencialiteti me Telekomin para disa kohe ku ju është lejuar më pas qasje në dhënat e Telekomit, mbi çfarë baze ju është dhënë kjo e drejtë? Dhe sa i përket kompanisë të cilën e keni ngarkuar lidhur me konsulencën për privatizimin, a keni ju informatë të saktë se kush janë këta njerëz si është e mundshme që një kompani ta marrë kontratën në ditën e cila regjistrohet në Prishtinë?

Për arsye të një takimi urgjent kryetarja e komisionit znj. Sala Berisha Shala, kërkoi që kryesimin e mbledhjes ta marrë anëtari i komisionit z. Muharrem Nitaj, në mungesë të dy zëvendëskryetarëve të komisionit, për të kryesuar mbledhjen.

Muharrem Nitaj, kryesues, ia kaloi fjalën ministrit për t’u përgjigjur në pyetje të deputetit Konjufca.

Valdrin Lluka, ministër, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara: Për ndërprerjen e kontratës me Z-Mobile, tha se kjo kontratë skadon në qershor të këtij viti 2019 dhe Bordi i Telekomit i ka filluar negociatat dhe janë duke diskutuar këtë çështje. Për kompaninë “Artillery One” tha, se menaxhmenti i Telekomit ka nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti me një nga kompanitë e interesuara për privatizimin e Telekomit, “Artillery One”, Ai theksoi se kjo marrëveshje i lejon kompanisë në fjalë qasje në të dhënat që disponon Ndërmarrja e Telekomit, në mënyrë që kur të ofertojnë për privatizim të dinë më mirë se çka do të blejnë. Ndërsa sa i përket Qeverisë së Kosovës nuk ka marrëveshje konfidencialiteti me këtë kompani. Pa u formuar komiteti ndërministrorë për privatizim nuk ka të drejtë askush të nënshkruajë marrëveshje të konfidencialitetit. Ai potencoi se privatizimi i Telekomit është i nevojshëm për ta shpëtuar këtë ndërmarrje në këtë situatë që është Telekom, privatizimi është i vetmi shpëtim që mund të ndodhë. Sa i përket privatizimit të Telekomit është Ligji për Ndërmarrjet Publike i cili e definon qartë këtë çështje. Ai tha, që tash fillon procedura e ristrukturimit të Telekomit dhe Telekom duhet të jetë në gjendje ta dëshmojë se do mund ta kthejë kredinë që pritet të merret nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim–BERZH, pra kredia i jepet Telekomit, ka mundësi të kërkohet garanci nga Qeveria e Kosovës dhe besoj që kjo do të mund të sigurohet.

Galuk Konjufca potencoi se kompania “Artillery One”, është shumë e dyshimtë sepse me datën 4 shkurt është regjistruar, ndërsa, më 5 shkurt kanë nënshkruar kontratë me Telekomin.

Memli Krasniqi tha se është për keqardhje kur është propozuar që të privatizohet Telekom dhe nuk ka ndodhur në atë kohë, kur kjo ndërmarrje ka pas zhvillimin dhe vlerën financiarë më të madhën edhe në rajon dhe kur i ka dhanë devident shtetit çdo vit dhe sot kishim mundur të flasim vetëm për suksese të kësaj ndërmarrje. Ai tha që jemi në një situatë shqetësuese si nënshkruhen marrëveshjet e tilla pa miratimin e dikasterit përkatës, siç është kjo marrëveshje e

konfidencialiteti në mes menaxhmentit të Telekomit dhe kompanisë “Artillery One”. Potenco i se është shumë shqetësuese nëse nuk kanë të drejtë me nënshkruar kontrata të tilla menaxhmenti i Telekomit dhe nëse kjo mund të jetë problematike për të ardhmen atëherë kjo çështje duhet të trajtohet sa më shpejt. Andaj, nëse ka një projekt serioz Telekomit në ristrukturim të ndërmarrjes para privatizimit do vijë edhe kompani serioze dhe duhet qysh tani në hapat e para të sigurohen palët e interesuara që procesi është i drejtë, transparent dhe konkurrues.

Valdrin Lluka, ministër, ju sqaroi anëtarëve të komisionit se privatizimi nuk do fillojë menjëherë, pasi që Telekomit ende nuk e ka kaluar krizën e madhe brenda saj dhe ka kohë, nuk është diçka që do fillojë menjëherë procesi i privatizimit pasi që Telekomit njëherë është në një gjendje shumë të keqe. Lidhur me rezolutën e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, tha disa prej pikave të Rezolutës i kemi trajtuar paralelisht, menjëherë si angazhimi i Auditorit të Përgjithshëm të Telekomit këtë e kemi bërë menjëherë.

Kryesuesi tha që pajtohet se duhet kërkuar sqarime nga lidhur me marrëveshjen konfidenciale që është nënshkruar në mes menaxhmentit të Telekomit dhe kompanisë “Artillery One”, se çka ka ndodhur me këtë çështje. Pyeti se a ka Ministra e Zhvillimit Ekonomik ndonjë plan se kur do të përfundojë procesi për fillimin e privatizimit të ndërmarrjes publike Telekom?

Lutfi Zharku, kërkoi sqarime, se a ka raport nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik, që ju keni rekomanduar Qeverisë privatizimin e Telekomit, apo po e priteni formimin e Komitetit ndërministror kur do të vendos privatizimin e kësaj ndërmarrje?

Glauk Konjufca kërkoi sqarime për kompaninë “Artillery One” dhe për kompanitë e tjera që po takohen me ministrin se a ju është bërë verifikimi nga MZHE-ja këtyre përfaqësuesve të këtyre kompanive që janë të interesuar për privatizimin e Telekomit se mos janë kompani fantome sikur që ishte rasti me kompaninë AXOS?

Valdrin Lluka, ministër, sqaroi se si ministër i MZHE-së takohet më të gjitha palët dhe përfaqësuesit e kompanive që kanë interesim për t’u njoftuar me procesin e privatizimit të Telekomit, këto takim janë publike, dhe jam takuar edhe me kompani tjera ndërkombëtare, që kanë aplikuar siç janë ORANGE, A1 etj. Ndërsa, sa i përket verifikimit të përfaqësuesve të këtyre kompanive, tha që janë institucionet tjera përkatëse që e bëjnë verifikimin. Ai theksoi se dikasteri që e drejton është shumë i preokupuar me gjendjen financiare të Telekomit pasi ka pasur disa humbje të mëdha të cilat e kanë keqësuar gjendjen financiare të kësaj ndërmarrje. Andaj, MZHE-ja është thellësisht e preokupuar me gjendjen financiare të Telekomit, ne jemi dëshmitarë ku Telekomit ka pasur një barazim të humbjeve, proceset e shumta të humbura kanë vështirësuar gjendjen financiare. Ai tha që nga marrja e mandatit si ministër ka punuar për ta adresuar secilin problem të Telekomit. Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar në përmirësimin e ndërmarrjes së Telekomit. Ndërsa, sa i përket vendimit të fundit, ky vendim është i bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe janë respektuar të gjitha procedurat dhe kërkon aprovimin e Kuvendit të Kosovës. Potenco i se cili do rekomandim që del nga komiteti ndërministror do t’i paraprijë procesit të ristrukturimit të kësaj ndërmarrjeje sa i përket kredisë që synohet të merret, kjo kredi do të ketë një plan investiv që hollësisht arsyeton marrjen e saj dhe investimin në teknologji që përmirëson shërbimin ndaj konsumatorëve. Kjo do të jetë shumë transparente dhe kjo kredi do të jepet vetëm për shpenzime kapitale rregullimin e

infrastrukturës në teknologji të Telekomit. Sa i përket raporteve të pa audituara ne mund t'i sjellim edhe me herët, por nuk e di sa mund të jenë të besueshme pa qenë të audituara.

Pas debatit, Kryesuesi, nxori në votim vendimin e Qeverisë, për ti rekomanduar Kuvendit miratimin ose mosmiratimin e tij, por në votim morën pjesë vetëm katër (4) deputetë dhe ata votuan "për", andaj, në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mungesë të vendimmarrjes kjo çështje votohet në një nga mbledhjet e radhës.

4. Diskutim për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Kryesuesi tha sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, në mbledhjen e kaluar është ezauruar debati, andaj, kërkoj nga grupet parlamentare që të propozojnë anëtarët e vet në grup pune për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime.

Komisioni unanimisht vendosi për formimin e grupit punues dhe nxori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimet;
2. Grupi punues ka këtë përbërje: Sala Berisha -Shala kryesuese, Liburn Aliu dhe Veton Berisha anëtarë;
3. Grupi punues ne bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në komision.

5. Të Ndryshme Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA